

URDHËR
Nr. 117, datë 16.2.2018

**PËR ÇAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË DHE DETYRAVE TË
ZËVENDËSMINISTRIT NË MINISTRINË E KULTURËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të nenit 22 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 3, 5 dhe 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 507, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e fushave të përgjegjësisë dhe detyrave të zëvendësministrit në Ministrinë e Kulturës, znj. Valbona Shujaku, sipas përcaktimeve të këtij urdhri.

2. Zëvendësministri i Kulturës, znj. Valbona Shujaku, të ndjekë dhe të përgjigjet para ministrit për çështjet në fushën e artit, të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore sipas këtyre prioriteteve:

- a) Hartimin e programit kombëtar të “Edukimit përmes kulturës”, për vitin arsimor 2018–2019;
- b) Koordinimin e kalendarit të aktiviteteve në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore që zhvillohen në kuadër të edukimit përmes kulturës;
- c) Bashkëpunimin me institucionet e përfshira në programin kombëtar të edukimit përmes kulturës;
- ç) Drejtimin e grupit të punës për hartimin e “Strategjisë kombëtare të kulturës”, brenda vitit 2018;
- d) Koordinimin me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare për angazhimin e tyre në hartimin e “Strategjisë kombëtare të kulturës”;
- dh) Zhvillimin e takimeve dhe angazhimin e organizatave kulturore aktive në fushën e artit dhe kulturës, pjesë e rrjetit “Skena e pavarur kulturore”, në hartimin e “Strategjisë kombëtare të kulturës”;
- e) Koordinimin dhe ndjekjen që nga faza e hartimit deri në zbatimin e “Kalendarit të përbashkët kulturor Shqipëri–Kosovë 2018”.

3. Përveç ndjekjes dhe raportimit të çështjeve të mësipërme, zëvendësministri ngarkohet të ndjekë edhe çështje të tjera, në zbatim të urdhrave të ministrit.

4. Ngarkohet zëvendësministri, znj. Valbona Shujaku, për zbatimin e këtij urdhri.

5. Urdhri i ministrit të Kulturës nr. 43, datë 19.1.2018, “Për caktimin e fushës së veprimtarisë që mbulon zëvendësministri në Ministrinë e Kulturës”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro (Furxhi)